

3673/5
29.09.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Regj.Them 1639
Regj 29.06.2016

Nr.1495. Vendimi
Datë 22.09.2016

V E N D I M

“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, e përbërë prej :

Gjyqtar- Astrit Shema

stuar prej sekretares gjyqesore Anila Rista, në Vlore, sot më datë 22.09.2016, përfundoi së shqyrtuari në uncë gjyqesore publike çështjen civile me Nr. 1639. Regj.Them, date paraqitje 29.06.2016, që i përket leve ndergjyqese :

dites : Subjekti "Sali Koreci", me nr. NiptL53402010F, me adrese Fshahi Shnik, Rr."Antipairea" Berat, I perfaqesuar ne kete gjykim me procure te posaceme me nr.1254.Rep. e nr.699.kol, date 14.07.2016, hartuar perpara noteres Nertiola Rahovica-dhoma e noterise Vlore, prej Claudio Koreci.

Paditur: 1.Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim me 3673/1.prot,date 15.07.2016, prej jursites se ketij institucioni znj.Silvana Sallo, (ne mungese ne ballje vendimi).

Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve, Drejtoria e Apelimit, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim me 22986/1.Prot,date 19.07.2016 prej jursites se DRTatimeve Berat znj.Silvana Sallo, (ne mungese ne ballje vendimi).


Ne pjesemarrjen e Avoaktures se Shtetit Zyra Vendore Vlore (Ne mungese)

Objekti I padise: Pavlefshmeri absolute te Njoftim Vleresimit.

-Njoftim Vlersimi per detyrimet tatimore Nr. 1942/1 date 15.04.2016 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat.

-Vendim Nr.12056/1 date 13.06.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.

bazuar Ligjore: "Nenet 31,32/a e vijues te Kodit te Procedures Civile, Ligji nr.49/2012 "Per Organizimin e Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Vlosmareveshjeve Administrative"; Kodi i Procedurave Administrative; Ligji nr. 10279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet Administrative"; Ligji nr. 10280 date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar; Udhezimi nr. 10281 date 02.09.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar Ligji nr.8438, date 12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat Personale" i ndryshuar si dhe udhezimet ne zbatim te tij.



Gjykata pasi mori provat e nevojeshme, si degjoi ne kerkimet perfundimtare palet ne proces te cilat ne kerimin e tyre perundimtar u shprehen respektivisht :

Perf. I pales paditese I cili u shpreh :-Per pranimin e padise; Perf. i pales se paditur :-Per rrezimin e padise; si e analizoi ceshtjen ne teresine e saj :

VEREN :

Paditesi i është drejtuar kesaj gjykate, me padine e mesipercituar me objekt te mesipercituar.

Gjykata, pasi studioi materialet e ceshtjes civile me Nr.1639.Akti , date 29.06.2016.Rregj te paraqitur per gjykim, ne baze te nenit 36 te K.Pr.Civile, ne te cilin parashikohet shprehimisht se: "Ne juridiksionin e Gjykatave hyjne te gjitha mosmarreshjet civile dhe mosmarreshje te tjera te parashikuara ne kete Kod e ne ligje te vecanta" si dhe ne reference dhe te nenit 7 te ligjit me nr. 49/2012" Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" ne te cilin citohet se : " Gjykatat administrative jane kompetente per:

a) mosmarreshjet qe lindin nga aktet administrative individuale, aktet nenligjore normative dhe kontratat administrative publike, te nxjerra gjate ushtrimit te veprimtarise administrative nga organi publik; duke qene se ndodhemi perpara nje mosmarreshje me karakter administrativ qe rrjedh nga marredheniet civile mes paleve ndergjyqese", çmoi kryesisht se ceshtja e paraqitur eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate.

Gjithashtu ne reference te nenit 10 te ligjit te mesipercituar "Kompetenca funksionale" ne te cilin citohet se : " 1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarreshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative, arriti ne kunkludimin se kjo ceshtje eshte nen kompetencen funksionale te kesaj gjykate.

Ne lidhje me kompetence tokesore kjo gjykate j'u referuar nejit 11 te ligjit me nr. 49/2012" Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative" ne te cilin citohet se "1. Padite kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendren organi administrativ më i lartë.

Gjithashtu Gjykata, në vështrim të neneve 12 te ligjit te mesipercituar, çmoi ceshtje duhet gjykuar me nje gjyqtar te veten.

Rrethanat e ceshtjes

Subjekti "Sali Koreci" me nr.NIP-t L53402010F, zhvillon aktivitet privat "Riparim i produkteve metalike te fabrikuaara", qe nga data 02.10.2015 e ne vazhdim.

Me shkresen nr.1942/1 prot, date 15.04.2016, me lend: Njoftim Vlersim Per tatimin e Thjeshtuar mbi fitimin", jam njohur me detyrimin ne vleren 339.424 leke, te tatimit ta thjeshtuar mbi fitimin per vitin 2016.Kjo shume e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin do te jene ndare ne tremujore ne vleren 84.856 leke pertremujor.

Me vendimin nr.12056/1, date 13.06.2016 Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane ka Vendosur :

- Refuzimin e ankimit, per shkak se nuk eshte paguar apo nuk eshte vene garanci bankare per detyrimin e plote tatimor te percaktuar ne aktin administrative, objekt ankimi.

Per sa me siper pala paditese I eshte drejtuar Gjykates Administrative Vlore me kerkese-padi duke parashtruar faktet dhe rrethanat, ligjin perkates ku eshte mbeshtetur, analizen dhe arsyetimin ligjor te fakteve .

Pretendimet e pales paditese

Bejme me dije Gjykatën se DRT Berat ka gabuar në nxjerrjen e këtij vlersimi të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin që me është caktuar, pasi është një vlerë e lartë krahasuar me xhiron dhe aktivitetin që une ushtroj.

Aktiviteti është hapur në tetor të vitit 2015, dhe në nëntor të këtij viti kam lidhur një kontratë njëvjeçare me një subjekt të tretë për periudhën 01.11.2015 deri në 11.10.2017 në vlerën 2.000.000 leke.

Kontrata është lidhur në datën 12.10.2015, me subjektin AMA-DRESS Sh.P.K me nr.Nipti L13407001E, kjo kontratë perfundon në datën 11.10.2017, pra do të zgjase për një afat kohor 2 vjeçar.

Kontrata është përpiluar dhe firmosur me vullnetin e lire të paleve, pa akt noterial. Qëllimi i kësaj kontrate është:

Mirëmbajtjen dhe shërbimin e të gjitha makinerive në firmën Ama-Dress, sipas afateve dhe kushteve të makinërive.

Suport teknik për makinat qepse dhe për makinën e qendësjes, makinat speciale.

Në kushtet e kontratës është përcaktuar që pagesa do të bëhet çdo ditë 20 të muajit, por me marrëveshje gojore kemi vendosur që pagesa të bëhet njëherësh, dhe kjo e vertetuar nga xhirimi bankar i datës 09.03.2016, me lehtë likuidim fature nr.9 nga Ama -Dress., me vlerë 2 000 000 leke.

Duke respektuar legjislacionin tatimor, këtu shumë e kam deklaruar në vitin 2015 sepse u bë parapagim dhe si rrjedhim i kësaj u ritën të ardhurat e vitit 2015.

Duke u bazuar në këtë deklaram, DRT Berat me ka vlersuar Tatim të Thjeshtuar mbi Fitimin për vitin 2016, e cila është në një shumë tejte të lartë duke u nisur nga xhironja që une kam.

Thëksojmë se xhironja ime deri në dt.14.04.2016 është 69 600 leke, ndërkohe që për një periudhë tremujore, koston e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është në vlerën 84 856 leke, që është qartësisht e dukshme që detyrimi im për të paguar është më i lartë se xhironja që une kam. Bashkëngjitur po ju dergojmë gjendjen e kaksës për të verifikuar xhiron të aktuale, koston e tatimit fitimit që kam nxjerr nga sistemi dhe deklaratën tatimore të vitit 2015.

Bazuar në nenin 30, pikë 5 të ligjit Nr.8438, datë 28.12.201998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat Personale" i ndryshuar ku citohet se:

"Në rastin kur tatimpaguesi, nëqdo kohë, gjatë periudhës tatimore, verteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogelimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzime të Ministrisë të Financave. Në rast se subjekti taksapagues ka ulur koston e parapagimit, të caktuar nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor për vitin të tatimit, që rezultoi nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10 për qind, subjekti duhet të paguajë kamatëvonesë mbi diferencën ndërmjet detyrimit real për vitin dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzime të Ministrisë të Financave".

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, për të cilën koston e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin duhet të shikoj edhe gjendjen faktike të subjektit, nuk mundet që një sistem informatik të marrë dhe përdhonoris automatikisht koston, duke hamendësuar xhiron e biznesit që une ushtroj për vitin pasardhës. Bejme me dije gjykatën se të ardhurat në vlerën prej 2 000 .000 lekesh janë për shërbimin që do kryej për një periudhë 2 vjeçare në subjektin Ama -Dress.

Për sa më sipër nga ana e Drejtorisë rajonale Tatimore Berat nuk është vlersuar drejt dhe si duhet koston mujor dhe vjetor i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

Kërkojmë përfshirjen absolute të :Njoftimit Vlersimit për detyrimin tatimor për faktin se: -Ky akt është në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, sepse proceduralisht subjektet që kanë një xhiro me të vogël se 5 milion leke, ligji i ka përjashtuar nga pagesa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

Në rastin konkret subjekti im nuk e ka kalon xhiron vjetore prej 5 milion lekesh. dhe normalisht nuk mund të tatohet në bazë të ligjit për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin. Me konkretisht në nenin 11 pikë 2 e ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për taksat vendore" i ndryshuar, ku shprehet se:

Shkalla tatimore

"1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshem, për tatimpaguesin që i nënshtrohen tatimit të

thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel, me qarkullim vjetor nga : (pese) cleri ne 8 (tele) milione leke, eshte 5 per qind.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, per tatimpaguesit me qarkullimvjetor nga 0 (zero) deri ne 5 (pese) milione leke, eshte 0 (zero) leke ne vit"

Per sa me siper Drejtoria Rajonale tatimore Berat nuk mund te hamendesoj se xhoroja ime per vitin pasardhe do te jet me e larte se kjo vler duke u bazuar vetem ne deklarimin e fatures ne vleren 2 000 000 leke te deklaruar ne tremujorin e fundit te vitit 2015.

Nisur nga sa me siper ne mbeshtetje te Neneve 31,32/a,35,36,41,42 106 te kodit te Procedures Civile, Ligjit me nr.49 date 03.05.2012, "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative, ligji nr.8485 date 12.05.1999 "K.Pr.Administrative",Ligji nr.10279, date 20.05.2010 "Per Kundravajtjet Administrative" ligji nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", I kerkojme gjykates:"Konstatimin e pavlefshmerise absolute si dhe shfuqizimin e akieve administrative Njoftim Vlersimin per detyrimet tatimore nr.1942/1 date 15.04.2016 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat.2.Shfuqizimin e Vendimit Nr.12056/1 date 13.06.2016 te Drejtorise --e Apclimit Tatimor Tirane ".

Prapesimet e pales se paditur

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, ka vepruar konforme procedurave ligjore. ne interpretim dhe ne zbatim te ligjit dhe nuk ka bere asnje shkelje te nenit te siperpermendur duke sqaruar hap pas hapi si me poshte:

1-Drejtoria Rajonale Tatimore Berat eshte organ i identifikuar, dhe bazuar ne nenin 13 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise"" i ndryshuar dhe Udhezimit nr.24 date 2.09.2008 "Per Procedurat Tatimore Ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar. DRT Berat eshte organi kopetente per nxjerrjen e akteve administnitive. bazuar keshtu [he ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i idryshuar, neni 14 dhe Udhezimit nr.24 date 2.09.2008 "Per Procedurat Tatimore Ne Republiken : Shqiperise", pika 14.1 Administrimi tatimor shprehet se:'Ne zbatim te pikes 1 te nenit 14 te Ligjit, Drejtoria e Pergjithshme e Talinu ve, bashke me Jrejtorete rajonale te saj, eshte autoriteti i vetem tatimor qendror ne Republiken e Shqiperise. Si tille, ajo eshte i vetmi autoritet qe pranon deklaratat tatimore per tatimet a he taksat kombetare, perfshire deklaratat per kontributet e sigurimeve shoqerore she shendetesort. vlereson detyrimet atimore, kontrollon sakesine e deklarimit dhe, mbi kete baze, percakton del vrimel tatimore htese te nje tatimpaguesi dhe rimbursimin apo kthimin e tatimeve te paguaiti teper. nese ka te ilia. Asnje organ tjeter, perfshire ketu Kontrollin e Larte te Shtetit dhe struk urat e tjera le 'uditimit te jashtem, nuk ka te drejte te kontrolloje, tepercaktoje apo ndryshoje shumen e 'etyrimeve tatimore te tatimpaguesve te vegante."

Aktet administrative Njoftim Vlersimin per detyrimet tatimore 1942/1 prot. date 5.04.2016 dhe vendimit nr.12056/1, date 13.06.2016 i Drejtorise se Apclimit Tatimor prane)PT Tirane,, jane nxjerre ne formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji. duke sqaruar si me oshte:

Njoftim Vlersimin per detyrimet tatimore Nr. 1942/1 prot date 15.04.2016, ka dale ne baze te deklarimit te kryer nga vet subjekti, i cili per nje periudh tremujore ka deklaruar nje xhiro ne vleren 2 000 000 leke.

Njoftim Vlersimin ka dale ne formen e kerkuar nga ligji dhe jo ne kapercim te ompetencave ligjore nga ana e organit tatimor, dhe si rezultat i deklarimit te xhiros per nje eriu dh tremujopre ne vleren 2 000 000 leke, eshte ber dhe perdhogaritja nga ana e sistemit lformatik ne lidhje me tatimin e thjesht mbi fitimin per vitin 2016 ne vleren 339 424 leke, shue e do te jete e ndare ne tremujaor ne vleren 84 856 leke per tremujor.

Referuar Ligji nr.10279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet Administrative", bejme me ije Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Vlore se nga ana e DRT Serat per nxjerrjen e njoftim Vlersimin per detyrimet tatimore, jane respektuar procedurat ligjoiv sic i percaktohet ne ligjin ne fjale e dhe nuk kemi asnje kapercim te kompetencave ligjore ne nxjer jen e ketij Njoftim "lresimi.

Me vendimin nr.12056/1 date 13.06.2016 te Drejtorise se Apclimit Tatimor eshte vendosur:

- Refuzimin e ankimit, pasi nuk janë permbushur kërkesat dhe procedurat në lidhje me mosrespektimin e alatit të araqitjes së kërkesës për apelim në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë, bazuar në pikën 106.3 të Udhezimit.

Aktet tona administrative të nxjerrë shoqërisht "Mangalemi" shpik janë kryer neperputhje me ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 të "Kodit të Pr. Administrative" dhe ligjit në fuqi "Per Procedural Tatimore".

Per sa me sipër, Njoftim Vleresimit Nr. 1942/1 prot. datë 15.04.2016 nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat si dhe Vendimit nr.12056/1 datë 13.06.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë, është i mbështetur në ligj, si dhe mbështetur në Legjislacionin e siperpermendur, në nenin 331/1 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 40 pika 3 të ligjit me nr.49 datë 03.05.2012, "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" : Kërkojmë :Rrezimin e Kerkese Padise të ngritur nga Subjekti "Sali Koreci", dhe lenien në fuqi të akteve tona administrative si të drejta dhe të bazuara në ligj.

Legjislacioni I zbatueshem

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, parashikon se:

"Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

Ky parashikim kushtetues është në të njëjtën linjë me neni 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore:

"Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e cdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar".

Ndërkohë, gjykatat detyrohen edhe nga neni 44 i Kushtetutës, sipas të cilit:

"Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Për sa më sipër, vendimi objekt shqyrtimi do të trajtohet nga gjykata si cdo akt administrativ. Në nenin 15 të ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet, se: Te drejten e padise e ka :a)cdo subject,qepretendon se I eshte cenuar nje e drejte apo nje interes I ligjshem nga nje veprim apo mosveprim I organit public;

"Padia, sipas nenit 17 të këtij Ligji mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cënohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive...".

Ligji me nr.9920,datë 19.05.2008"Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise".

Kodi I Procedures Admnistrative te Republikës se Shqiperise,nenet 116,117.

Zgjidhja ligjore

Gjykata në lidhje me barren e proves , ka për reference nenin 35 të ligjit me nr. 49/2012" Për

organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"-Barra e proves ne te cilin citohet se :*"1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.*

Duke vlerësuar në tërësi rrethanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të KPrC dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjorë që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit *"Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët.*", arrin në konkluzionin se padia duhet pranuar për arsyet si më poshtë vijon:

Çeshtjet ne lidhje me pavlefshmerine absolute te aktit administrativ, jane ne juridiksionin gjyqesor. Ne gjykime te ketij lloji, kur pretendohet pavlefshmeria absolute e aktit administrativ, ligjvenesi ka parashikuar qarte ne nenin 117 te K.Pr.Civile dhe ne nenin 16 12, pika b) te Ligjit 49/2012 *"Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"*, qe cdo person i interesuar, ne cdo kohe, ka te drejte t'i drejtohet drejtpersedrejt gjykates, per te kerkuar konstatimin e kesaj pavlefshmerie. Keto dispozita shprehimisht parashikojne se:

Neni 117 i K.Pr.Administrative:

1. *Aktet administrative absolutisht te pavlefshme nuk prodhojne pasoja ligjore pavaresisht nga fakti nese jane deklaruar apo jo si te tille.*

2. *Secila pale e interesuar mund te kerkoje qe akti administrativ te shpallet absolutisht i pavlefshem. Kerkesa ne fjale mund te behet ne cdo kohe. Organi administrativ kompetent, me iniciativen e tij, mundet te deklaroje nje akt administrativ absolutisht te pavlefshem ne cdo kohe.*

3. *Ne qofte se vetem nje pjese e aktit eshte absolutisht e pavlefshme, i gjithë akti do te konsiderohet absolutisht i pavlefshem ne rast se pjesa qe anulohet eshte aq e rendesishme sa qe organi administrativ nuk do ta nxirrte aktin pa kete pjese.*

Neni 16 i Ligjit 49/2012:

3. *Padia ndaj veprimit administrativ mund te ngrihet vetem pas shterimit te ankimit administrativ.*

4. *Perjashtohen nga ky rregull rastet kur:*

ligji nuk parashikon organ me te larte per paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me i larte administrativ nuk eshte konstituuar;

e) ligji parashikon shprehimisht te drejten per t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtperdrejt ne gjykate;

j) organi me i larte ne shqyrtimin e nje ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, te drejtat apo interesat personale te ligjshem te nje personi, i cili nuk ka qene pale ne procedimin administrativ.

Ne analize te dispozitave te mesiperme rezulton qarte qe per kete lloj kerkimi, (konstatimi i pavlefshmerise absolute te aktit administrativ), **gjykata ka juridiksion te drejteperdrejte dhe merr ne shqyrtim ceshtjen, pavaresisht se paditesi nuk ka ezauruar rrugen administrative te parashikuar shprehimisht ne nenin 106 dhe 107 te Ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne RSH".** Pikerisht ky lloj kerkimi, merret ne shqyrtim drejtpersedrejt nga ana e gjykates, per shkak se nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem prezumohet se ka shkelje te tilla thelbesore te ligjes, te cilat e bejne ate qe te mos kete asnje mundesi veprimi ne asnje moment dhe te konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjehere.

Ligjvenesi ka parashikuar juridiksion te drejteperdrejte ne gjykate te ketij kerkimi, pasi nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem, qe nga momenti i nxjerrjes se tij, nuk krijon dhe as mund te krijojë pasojat juridike per te cilat ai eshte nxjerre.

Nje akt absolutisht i pavlefshem nuk eshte akt, ai eshte nje nulitet i plate, i cili konsiderohet se nuk ka hyre ne fuqi asnjehere. Per shkak te shkeljes se rende thelbesore te ligjes, pavlefshmeria absolute e nje akti nuk mund te rregullohet ne te ardhmen, as nga palet dhe as nga organi qe ka leshuar aktin, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjehere.

Si i tille ai nuk mund te kete fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve, te cileve iu kundrejtohet dhe as ndaj organeve te tjera te administrates shteterore.

Ne keto kushte, si keto subjekte dhe organet te cilave ai iu drejtohet kane te drejte te refuzojne permbushjen e detyrimeve apo urdherimeve qe rrjedhin nga ky akt, pa qene nevoja qe per pavlefshmerine e tij te shprehet patjeter ndonje organ shteteror.

Per shkak te kesaj vecorie qe ka akti absolutisht i pavlefshem, ligjvenesi ka parashikuar qe cdo pale e interesuar ka te drejte te kerkoje nga ana e gjykates konstatimin e pavlefshmerise absolute dhe jo deklarimin e saj. Prandaj, kur gjykata gjate gjykimit te ceshtjes, konstaton se akti eshte absolutisht i pavlefshem, ajo nuk shpall deklarimin e pavlefshmerise, por vetem e konstaton ate dhe zgjidh pasojat juridike qe vijne per palet nga ky akt absolutisht i pavlefshem.

Kjo eshte dhe arsyeja, perse kerkimi per konstatimin e pavlefshmerise absolute te nje akti administrativ, nuk i nenshtrohet ndonje afati te vecante parashkrimi, por behet nga cdo pale e interesuar, ne cdo kohe.

Kete qendrim kane mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne vendimin unifikues nr. 3/2008, ku shprehimisht thuhet: "38.3 nese pretendohet pavlefshmeria absolute e akteve, kerkim qe nuk eshte i nderuar nga ndonje afat parashkrimi, gjykata, nuk mund te nxjerre ceshtjen jashte juridiksionit gjyqesor, por ne zbatim te nenit 121 te KPr. Administrative dhe 331 te K.Pr. Civile, konstaton pavlefshmerine per efekt te zgjidhjes se pasojave juridike qe jane krijuar nga akti.

Ne gjykimin e kesaj ceshtje, gjykata ka per detyrim ligjor te hetoje nese ndodhemi ne kushtet e pavlefshmerise absolute te akteve administrative te nxjerra nga pala e paditur DRTatimeve berat ne lidhje me percaktimin e detyrimit per tatimin e thjeshtuar me fitimin per palen paditese per vitin 2016, ku palen paditese e ka njohur me detyrimin toatral pwer k vitin 2016 ne masen prej 339.424 leke, e ndate ne tremujore ne masen prej 84.856 leke.

Per efekt te gjykimit , te kesaj ceshtje u provua nga séance gjyqesore se :

- Subjekti "Sali Korecr eshte regjistruar ne DRT Berat qe nga data 02.10.2015, me NIP-t L53402010F, me aktivitet privat "Riparim i produkteve metalike te fabrikuara", me adres Fshati Dyshnik, Rruga Antipatrea, Berat.
- Me Njoftim Vlersimin nr.1942/1, date 15.04.2016, jam njohur me vlersimin per pagimin e detyrimit te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin ne vleren 339.424 leke (ten dare ne tremujor ne vleren 84.856 Leke).
- Aktiviteti eshte hapur ne Tetor te vitit 2015, dhe ne Nentor te ketij viti kam lidhur nje kontrat njevjecare me nje subjekt te trete per periudhen 01.11.2015 deri ne 01.11. 2016 ne vleren 2.000.000 leke.
- Pala paditese kete shume e ka deklaruar si te ardhur per vitin 2015 sepse u be parapagim dhe si rrjedhoje e saj u pasqyruan te rritura te ardhurat e periudhes se fundit te vitit 2015.
- DRTaqtimeve Berat, ne menyre apriorike, duke u bazuar ne kete deklarim me ka e ke vleresuar Tatim e Thjeshtuar mbi Fitimin per vitin 2016 per palen paditese, e cila eshte ne nje shume tejet e lart duke u nisur nga xhirua qe qe ajo kryen faktikisht.
- Bazuar ne provat e paraqitura nga pal paditese rezulton se xhiroja e saj deri ne date 14.04.2016 eshte 69.600 leke, nderkohe qe per nje periudh tremujore, kesti i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin eshte ne vleren 84.856 leke, qe eshte qartesisht e dukshme qe detyrimi im per te paguar eshte me i larte qe xhiroja qe ajo kryen.

Bazuar ne nenin 30, pika 5 te ligjit Nr.8438, date 28.12.201998 "Per Tatimin mbi te ardhurat personale" i ndryshuar ku citohet se: "Ne rastin kur tatimpaguesi, ne cdo kohe, gjateperiudhes tatimore, verteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin per kete periudhe tatimore do te jete, nemyre domethene se, me i ulet se tatimi mbi fitimin ne periudhen paraardhese ose periudhen e dyteparaardhe se,

alehere organet tatimore pranojne zvogelimin e parapagimeve, sipas rregullave te vendosura me udhezim te Ministrit te Financave. Nerast se subjekti taksapagues ka ulur kestet e parapagimit, te caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor per tatimjtimin, qe rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me me shume se 10 per qind, subjekti duhet te paguaje kamatevonesa mbi diferencen ndermjet detyrimit real vjetor dhe shumës se parapaguar gjate vitit, sipas rregullave te vendosura me udhezim te Ministrit te Financave".

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, para se te vlersonte kestin e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin duhet te shikoj edhe gjendjen faktike te subjektit, nuk mundet qe nje sistem informatik te marr dhe perlllogaris automatikisht kestin, duke hamendesuar xhiron e biznesit qe pala paditese do te ushtroje per vitin pasardhes, duke u nisur vetem mbi bazen e nje kontrate me afat dy vjecar qe subjekti ka lidhur me nje subjekt te trete per periudhen 01.11.2015 deri ne 11.10.2017 ne vleren 2.000.000 leke.

Kontrata eshte lidhur ne daten 12.10.2015, me subjektin AMA-DRESS Sh.P.K me nr.Nipti L13407001E, kjo kontrat perfundon ne daten 11.10.2017, pra do te zgjase per nje afat kohor 2 vjecar.

Te ardhurat ne vleren prej 2 000 .000 lekesh jane per sherbimin qe do kryej per nje periudh 2 vjecare ne subjektin Ama -Dress.

Per sa me siper nga ana e Drejtorise rajonale Tatimore Berat nuk eshte vlersuar drejt dhe si duhet kesti mujor dhe vjetor i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin, duke shkelur ne menyre flagrante procedure qe duhet nduekur ne kete rats per vleresimin e detyrimeve per palen paditese per pagumimin e taksës vjetore per zhvillimin e aktivitetit te saj si subjekt, kur vlera e xhiros vjetore nuk I kalon shumen e xhiros mbi 5 milion leke.

Ne rastin konkret subjekti padites nuk e kalon xhiron vjetore prej 5 miljon lekesh. dhe normalisht nuk mund te tatohet ne baze te ligjit per tatimin e thjesht mbi fitimin.

Me konkretisht ne nenin 11 pika 2 e ligjit nr.9632 date 30.10.2006 "Per taksat vendore" i ndryshuar, ku shprehet se: *Shkalla tatimore*

"1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshem, per tatimpaguesil qe i nenshtrohen tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel, me qarkullim vjetor nga : (pese) cleri ne 8 (tele) milione leke, eshte 5 per qind.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, per tatimpaguesit me qarkullimvjetor nga 0 (zero) deri ne 5 (pese) milione leke, eshte 0 (zero) leke ne vit"

Per sa me siper Drejtoria Rajonale tatimore Berat nuk mund te hamendesoj se xhoroja e ktij subjekti per vitin pasardhe do te jet me e larte se kjo vlere duke u bazuar vetem ne deklarimin e fatures ne vleren 2 000 000 leke te deklaruar ne tremujorin e fundit te vitit 2015.

Pra pala e paditur ka kryer vendimarrje ne kundershtim me ligjin, duke e bere vandimarrjen e tyre ne aktet administrative te konsttauar si akte absolutisht te pavlefshme dhe per rrjedhoje ato akte nuk mundte sjellin pasoja.

Persa me siper u provau me parashtrimet dhe prapesimet e paleve ne gjykim dhe provat qe ato paraqiten.

Perfundimisht gjykata krijoi bindjen se padia eshte e bazuar ne prova dhe ne ligj dhe per rrjedhoje duhet pranuar.

Ne mbeshtetje te nenit 106 te K.Pr.Civile, duke qenese kjo padi u pranua nga ana e gjykates, atehere taksa mbi aktet, shpenezimet e tjera gjyqesore dhe per nje avokat i ngarkohen pales paditese/inicueses te ktij gjykimi.

Vlen te theksohet se ku vendim ne mbeshtetje te nenit 45 te ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarveshjeve administrative » duke qene se ceshtje objekt gjykim I ka te beje me aktet administrative objekt mkonflikti gjyqesor me vleren me pak se 20 fishi I apges minimale ne shkalle vendii ky vendim eshte I pa ankimueshem ne shkallet me te larta te gjyqesorit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar ne nenin 126 dhe 310 te K.Pr.Civile dhe nenet 40, 42 te ligjit me nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative":

VENDOSI:

- Pranimin e kerkese-padise.
- Konstatimin e pavlefshmerise absolute te akteve administrative : -Njoftim Vleresimi per detyrimet tatimore Nr. 1942/1 date 15.04.2016 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat dhe - Vendim Nr.12056/1 date 13.06.2016te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës se paditur.
- Ky vendim eshte i formes se prere konform nenit 45 te ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative ».

U shpall, ne Vlore me date 22.09.2016.

SEKRETARE

Anila Rista



GJYQTARI

Astrit Shema



SHPENZIMET GJYQESDORE

Takse padie 3.000 leke
Takse njoftimi 240 leke
Shpenzime avokatie 0 leke
Shuma totale 3.240 leke

